

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale E Formimit Profesional Publik Nr 1, Tiranë

PROGRAMI I KURSIT NË NIVEL OFRUESI

“WEB DESIGN”

KODI: WD-2020

Grupi i punës

Ened KUKO
Mario LIPO
Irena Ali
Alkend Brari
Blerta Arapi
Arben Spaho
Fatime Xhaferaj

Instruktor , DRFPP 1, Tiranë
Specialist IT, DRFPP 1, Tiranë
Spec.njesisë së zhvillimit Dfpp.nr.4 Tiranë
Instruktor Drfpp.nr 4 Tiranë
Spec.njesisë së zhvillimit Drfpp.Vlorë
Instruktor Drfpp Vlorë
P. Biznesi “Universal Design”

Udhëhoqi:

Oligerta LOGA

SPECIALISTE. E NJËSISË SË ZHVILLIMIT

DRFPP 1, TIRANË

Miratoi:

DREJTOR

2020

PROGRAMI I KURSIT

“Web design”

I. Profili Profesional i disenjuesit të Web-it.

a) Karakteristikat e disenjuesit të Web-it.

Disenjuesi i Web-it do të jetë i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar në subjekte private ose si i vetëpunësuar

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, disenjuesi i Web-it duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale të punonjesit të webit.

Suksesi i disenjuesit të Web-it është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: kreativiteti, shkathtësia, përqëndrimi, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj, sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe të përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale disenjuesit të Web-it.

Profesioni i disenjuesit të Web-it është i lidhur ngushtë me procedurat e punës në lidhje me përdorimin e gjuhës së kodeve për krijimin e përmbajtjes e faqeve të internetit, për stilimin e përmbajtjes së faqeve të internetit, dhe interaktivitetin e tyre.

Disenjuesi i Web-it realizon përpunimin dhe optimizimin për faqet e thjeshta të internetit, të figurave në programin photoshop, për krijimin, zhvillimin edhe mirëmbajtjen e faqeve të interneti

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht e duke ngritur shkallët e karrierës.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “**Hartues te multimedias dhe të rrjetit**”, me kod 2513, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për Web Design

Në përfundin të Kursit për Web Design, kursantët do të jenë të aftë të:

- përdorin gjuhën e kodeve për krijimin e përmbajtjes e faqeve të thjeshta të internetit;
- përdorin gjuhën e kodeve për stilimin e përmbajtjes së faqeve të thjeshta të internetit;
- përdorin gjuhën e kodeve për interaktivitetin e faqeve të thjeshta të internetit;
- kryejnë lidhjet dhe paraqitjen e figurave me kodet HTML;
- përdorin teknika dhe efekte të avancuara në CSS;
- kryejnë editim dhe prerje të fotografive në photoshop;
- krijojnë struktura faqe web vizualisht në photoshop;
- realizojnë përpunimin dhe optimizimin për faqet e internetit të figurave në programin photoshop;
- krijojnë kode HTML5 dhe CSS3;
- identifikojnë dhe zgjidhin probleme të ndryshme responsive;
- ndërtojnë faqe responsive;
- përdorin operatorët aritmetikë, krahasues dhe ata llogjikë;
- aksesojnë format dhe zhvillojnë kontrollet e fushave të formave me javascript;
- mirëmbajnë e faqet e internetit;
- përdorin sipas nevojave të gjitha veglat, mjetët e punës dhe bazën material;

- punojnë në ekip në rastet kur puna zhvillohet zinxhir;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- zbatojnë legjislacionin e punës;
- zbatojnë rregulla të komunikimit me eprorët, kolegët, klientët.
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë, higjienës dhe mbrojtjes së mjedisit.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Web Design.

Pjesëmarrësit në Kursin për Web Design duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të ketë njohuri në programet bazë kompjuterike.

Kohëzgjatja e Kursit për Web Design.

240 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për web Design.

Nr	Titulli i Modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatët Mësimore
1	Hyrje në profesionin e dizenjuesit të web-it.	WD-01-2020	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori 20% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit të web-it. 2. Kursanti përshkruan ndërtimin dhe strukturën e faqeve të Web-it. 3. Kursanti përshkruan strukturën e ndërtimit të dosjes që përmban sitin.
2	Aplikime në gjuhën HTML.	WD-02-2020	60 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti zhvillon e kode dhe tekste me kodet HTML. 2. Kursanti zhvillon lidhjet dhe paraqitjen e figurave me kodet HTML. 3. Kursanti përshkruan zhvillimin e ngjyrave dhe listave me kodet HTML. 4. Kursanti zhvillon tabela dhe forma me kodet HTML. 5. Kursanti zhvillon elemente të multimedive dhe sektorëve division.

3	Aplikime në gjuhën gjuhën CSS.	WD-03-2020	60 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti tregon konceptet dhe qëllimin e kodeve CSS dhe selektorët. 2. Kursanti krijon kode CSS mbi HTML, stilime dhe efektë mbi tekstin . 3. Kursanti kryen zhvillimin e hapësirave, zhvendosje të objekteve me CSS pozicionimet e objekteve. 4. Kursanti zhvillon prezantime të sfondeve dhe fotografive në objekte dhe zhvillon strukturën e faqes me CSS. 5. Kursanti përdor zhvillimin e teknikave dhe efektë të avancuara në CSS.
4	Punime në programin photoshop.	WD-04-2020	20 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan programin Photoshop. 2. Kursanti përshkruan karakteristikat e editimit të fotografive. 3. Kursanti përdorë mjetet e prerjes së fotografive. 4. Kursanti krijon formate të fotografive dhe optimizimin për web. 5. Kursanti krijon struktura faqe web vizualisht në Photoshop.
5	Ndërtimi i faqeve responsive.	WD-05-2020	40 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan konceptet, veçoritë, elementët e nevojshëm për të realizuar faqe responsive. 2. Kursanti krijon kode HTML5 dhe CSS3 . 3. Kursanti tregon njësitë matëse dhe media queries për përshtatje responsive. 4. Kursanti zhvillon modele responsive faqesh web, modele bootstrap. 5. Kursanti zhvillon sektorët e faqes, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve responsive.

6	Aplikime në gjuhën Javascript.	WD-06-2020	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e gjuhës Javascript dhe si aplikohet tek dokumenti, ndryshorët. 2. Kursanti përdor operatorët aritmetikë në Javascript. 3. Kursanti përdor operatorët krahasues dhe operatorët llogjikë. 4. Kursanti zhvillon funksionet e kushtëzuara, modelin DOM dhe eventet. 5. Kursanti zhvillon kontrollet e fushave të formave me Javascript.
----------	---	-------------------	---	--

VI. Vlerësimi dhe Certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatët Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futën në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit Web Design.

1. Moduli “Hyrje në profesionin e dizenjuesit të web-it.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E DIZENJUESIT TË WEBI-IT	WD-01-2020
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të dizenjuesit të Web-it, me mënyrën e funksionimit të faqeve të internetit, struktura e faqeve të internetit, mënyrat e ndërtimit të faqeve, konceptet baze për transferime të dosjeve.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 70% Teori; 20% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të ketë njohuri në programet bazë kompjuterike.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit të web-it. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës të dizenjuesit të web-it; - të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës të dizenjuesit të web-it; - të tregojë kërkesat profesionale dhe mundësitë e punësimit të dizenjuesit të web-it; - të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të profesionit të dizenjuesit të web-it; - të përshkruajë mënyrat e ndërtimit dhe funksionimit të internetit; - të përshkruajë konceptet mbi server, client-side, front-end; - të zbatojë rregullat e komunikimit me eprorët, kolegët, klientët; - të zbatojë legjislacionin e punës; - të zbatojë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti përshkruan ndërtimin dhe strukturën e faqeve të Web-it. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë llojet e ndërtimit të faqeve web; - të tregojë diferencën, përparësitë dhe mangësitë midis llojeve; - të përshkruajë rradhën e veprimtarive në ndërtimin e	

faqeve web;

- të tregojë rëndësinë për çdo etapë;
të përshkruajë strukturën bazë të faqeve web;
- të tregojë rolin e çdo elementi të strukturës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM.3 Kursanti përshkruan strukturën e ndërtimit të dosjes që përmban sitin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë strukturën e ndërtimit të dosjeve;
- të emërtojë dosjet që përmban sitin;
- të përshkruajë rolin e dosjeve;
- të përshkruajë lidhjet e faqeve HTML me dosjet që përmban root dosja.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik ose në mjediset e punës në një studio .
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete me mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin dhe kërkimin në internet etj.
- Atyre duhet t’iu jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të dizenjuesit të web-it , me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e dizenjuesit të web-it. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës, kabinet kompjuterik.
 - Kompjutera ,me programe aplikative të instaluar.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
-

2. Moduli “Aplikime në gjuhën HTML”.

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	APLIKIME NË GJUHËN HTML	WD-02-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët në krijimin e strukturës së faqeve, në krijimin e përmbajtjes së faqeve, elementët dhe sektorët e krijuar brenda strukturës HTML, komunikim me shfletuesin, njohjen me elementet e faqes, përdorimin e kodeve TAG.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të ketë njohuri në programet bazë kompjuterike dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e Dizenjuesit të Web-it”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti zhvillon kode dhe tekste me kodet HTML Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të njohë qëllimin dhe rolin e kodeve HTML; - të zhvillojë deklaratat në fillim të çdo faqeje web; - të zhvillojë kllapat hapëse dhe mbyllëse; - të zhvillojë sintaksën e kodeve HTML; - të zhvillojë kodet në HTML të titujve, modifikimit të karaktereve të tekstit; - të zhvillojë kodet në HTML të paragrafëve, llojit të tekstit; - të zhvillojë kodet në HTML të madhësisë së tekstit, të ndryshojë ngjyrën; - të zhvillojë kodet në HTML të atributëve dhe vlerave. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli RM 2 Kursanti zhvillon lidhjet dhe paraqitjen e figurave me kodet HTML Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të zhvillojë kodet HTML; - të krijojë lidhje me kodet në HTML; - të përshkruajë llojet e lidhjeve që përdoren në HTML; - të zhvillojë llojet e lidhjeve që përdoren në HTML; - të zhvillojë navigime të brendshme në faqe; - të zhvillojë kodet në HTML të fotografive; - të zhvillojë kodet në HTML të dimensioneve, raportit të figurave; - të zhvillojë formatet e figurave digitale dhe ti zbatojë në kode. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli	

RM 3 Kursanti përshkruan zhvillimin e ngjyrave dhe listave me kodet HTML.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë profilet e ngjyrave;
- të përshkruajë sintaksën e paraqitjes së ngjyrave me kode;
- të tregojë llojet e listave dhe elementët përbërës të tyre;
- të zhvillojë modifikime në lista;
- të alternojë listat me tekste, foto, lidhje.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti zhvillon tabela dhe forma me kodet HTML.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të zhvillojë tabela me kodet në HTML;
- të krijojë tabela me kodet në HTML;
- të zhvillojë modifikime në tabela;
- të zhvillojë struktura faqeje me tabela;
- të njohë elementet e formularëve në HTML;
- të zhvillojë formularë me HTML;
- të zhvillojë fusha të llojeve të ndryshme brenda formularit;
- të krijojë fusha të llojeve të ndryshme brenda formularit;
- të zhvillojë atributet dhe vlerat e inputeve të formularit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti zhvillon elemente të multimedive dhe sektorëve divizion.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të zhvillojë audio dhe video me kode HTML;
- të zhvillojë dimensionet e medias me kode HTML;
- të zhvillojë media nga platforma multimediale online;
- të zhvillojë sektorë të posaçëm me kode HTML për faqe web;
- të zhvillojë strukturime faqesh me sektorët divizion në dokumentin HTML;
- të zhvillojë kodet në HTML për emërtimet e divizioneve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik dhe në mjediset e punës në një studio. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete me mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin dhe kërkimin në internet etj. Atyre duhet t’iu jepen detyra si psh të krijojnë tabela me kodet në HTML dhe të kryejnë modifikime në tabela. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës në kabinet kompjuterik. - Kompjuterat ,me programe aplikativee instaluar. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesat, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Aplikime në gjuhën CSS”.

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	APLIKIME NË GJUHËN CSS	WD-03-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me gjuhën e kodeve CSS, stilimin e përmbajtjes së krijuar me HTML, teknikën e stilimit, mënyrën e implementimit, pozicionimin e objekteve dhe sektorëve të faqes, strukturimin e faqeve me CSS,	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të ketë njohuri në programet bazë kompjuterike, të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e Dizenjuesit të Web-it” dhe “Aplikime në gjuhën HTML”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e	RM 1 Kursanti tregon konceptet dhe qëllimin e kodeve CSS dhe selektorët Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:	

vlerësimi

- të tregojë qëllimin dhe rolin e kodeve CSS;
- të tregojë mënyrat e implementimit të kodeve;
- të njohë sintaksën e kodeve CSS;
- të krijojë selektorë CSS;
- të tregojë sintaksën e të shkruarit dhe të kërkuarit të selektorëve;
- të tregojë grupimet e selektorëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 2 Kursanti\ krijon kode CSS mbi HTML, stilime dhe efekte mbi tekstin***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë 3 mënyrat e veprimeve të kodeve CSS;
- të krijojë veprime inline me CSS;
- të krijojë veprime internal me CSS;
- të krijojë veprime external me CSS;
- të tregojë rëndësinë për formatim teksti me CSS;
- të tregojë rëndësinë për centrim teksti me CSS;
- të tregojë rëndësinë për ngjyrat dhe efektet e tekstit me CSS.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti kryen zhvillimin e hapësirave, zhvendosje të objekteve me CSS, pozicionimet e objekteve.***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë hapësirat e brendshme dhe të jashtme të një objekti;
- të zhvillojë hapësirat e brendshme dhe të jashtme të një objekti;
- të kryejë zhvendosje majtas-djathtas të objekteve;
- të kryejë alternime të figurave dhe tekstit në zhvendosje;
- të tregojë llojet e pozicionimeve të objekteve me CSS;
- të kryejë relacionet prindër - fëmijë midis objekteve;
- të zhvillojë struktura faqe me pozicionime.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti zhvillon prezantime të sfondeve dhe fotografive në objekte dhe zhvillon strukturën e faqes me CSS.***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të zhvillojë attribute dhe vlera për sfondin e objektit;

- të zhvillojë attribute dhe vlera për fotografitë;
- të zhvillojë attribute dhe vlera për transparencën e sfondit;
- të njohë elementet bazë të strukturës së një faqe web;
- të zhvillojë sektorin e kreut të faqes;
- të zhvillojë sektorin e fundit të faqes;
- të zhvillojë sektorin e galerisë së fotove të faqes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti përdor teknika dhe efekte të avancuara në CSS

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përdorë teknika dhe efektet për konturet e objekteve;
- të përdorë teknika dhe efekte për animacionin e objekteve;
- të përdorë teknika dhe efekte për hover;
- të zhvillojë menu navigimi të stiluar me CSS;
- të kryejë shfaqje të kontrolluara të teksteve dhe fotove;
- të përdorë teknika dhe efekte për transparencën, tranzitimin dhe transformimin e objekteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik dhe në mjediset e punës në një studio.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin dhe kërkimin në internet etj. Atyre duhet t’iu jepen detyra si të kryejne zhvendosje të objekteve në CSS, apo të përdorin teknika dhe efekte për transformimin e objekteve. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.

modulit	- Mjedise reale të punës - Kompjutera ,me programe aplikative të instaluar. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul
----------------	---

4. Moduli “Punime në programin PHOTOSHOP

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME NË PROGRAMIN PHOTOSHOP	WD-04-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që njeh kursantët me programin photoshop, ridimensionimin e figurave dixhitale nëpërmjet programit, përgatitjen e figurave për publikime në faqe interneti, formatet e figurave.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të ketë njohuri në programet bazë kompjuterike, të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e Dizenjuesit të Web-it”, “Aplikime në gjuhën HTML” dhe “Aplikime në gjuhën CSS”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan programin Photoshop. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë ambientin e programit dhe komponentet e tij; - të përshkruajë mënyrat e hapjes së një dokumenti të ri apo dokumenti ekzistues; - të kryejë hapjen e një dokumenti të ri apo dokumenti ekzistues. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti përshkruan karakteristikat e editimit të fotografive. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë përmasat dhe analizën e fotografive; - të njohë kompozime të dimensioneve të caktuara; - të krijojë kompozime të dimensioneve të caktuara. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 3 Kursanti përdor mjetet e prerjes së fotografive. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë mjetet slice dhe përdorimin e tyre;	

- të përdorë mjetet slice;
- të përdorë menyra të ndryshme prerje të caktuara për lidhje me kode HTML;
- të krijojë prerje të caktuara për lidhje me kode HTML.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti krijon formate të fotografive dhe optimizimin për web.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë formatet e figurave dixhitale;
- të konvertojë formate të përshtatshme për web;
- të krijojë formate të përshtatshme për web.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM5 Kursanti krijon struktura faqe web vizualisht në Photoshop.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë strukturat me shtresa;
- të krijojë struktura me shtresa;
- të përshkruajë shtresat e figurës;
- të përpunojë shtresat e figures;
- të përshkruajë element të faqes web fotografinë;
- të konvertojë në element të faqes web fotografinë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik dhe në mjediset e punës në një studio .
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete me mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin dhe kërkimin në internet etj. Atyre duhet t’iu jepen detyra si të krijojnë struktura vizualisht në photoshop.
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Kompjutera me programe aplikative të instaluar. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
---	--

5. Moduli “ Ndërtimi i faqeve responsive ”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	NDËRTIMI I FAQEVE RESPONSIVE	WD-05-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e faqeve web responsive, elementët e nevojshëm për ndërtimin e tyre, organizimin e strukturës së faqeve për prezantimin në celularë dhe tablet të faqeve responsive.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të kenë njohuri në programet bazë kompjuterike si dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e Dizenjuesit të Web-it”, “Aplikime në gjuhën HTML” , “Aplikime në gjuhën CSS” dhe “Punime në programin photoshop”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan konceptet, veçoritë, elementët e nevojshëm për të realizuar faqe responsive. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të tregojë qëllimin dhe konceptin e faqeve responsive; - të përshkruajë mënyrat e realizimit të faqeve responsive; - të përshkruajë shfletuesit e pajisjeve dhe karakteristikat e tyre; - të përshkruajë elementin e ri në sektorin head; - të përshkruajë elementin e ri në dokumentin HTML; - të përshkruajë elementin e ri në sektorin CSS. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Vëzhgim me listë kontrolli. RM 2 Kursanti krijon kode HTML5 dhe CSS3 . Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të krijojë tag-et e rinj të HTML5; - të krijojë element me HTML5; - të tregojë diferencat midis CSS dhe CSS3; - të realizojë përshtatje me CSS3. Instrumentet e vlerësimit:	

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti tregon njësitë matëse dhe media queries për përshtatje responsive

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë njësitë px, em, %;
- të tregojë ndryshimin midis tyre, konvertimin, zbatimin;
- të tregojë qëllimin e media queries dhe sintaksën e tyre;
- të krijojë break point me media queries.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM.4 Kursanti zhvillon modele responsive faqesh web, modele bootstrap

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë strukturën e faqeve të modelit responsive;
- të zhvillojë strukturë faqe për model responsive;
- të zhvillojë elementë të përshtatshëm për celularë;
- të përshtasë prezantimin e modelit për celularë;
- të kryejë aplikimin e bootstrap;
- të organizojë dosjet me bootstrap;
- të zhvillojë website me bootstrap.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti zhvillon sektorët e faqes, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve responsive.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë zhvillimin e selektoreve të faqeve;
- të zhvillojë website me HTML5 dhe CSS3 ;
- të zhvillojë website bazuar në HTML5, CSS3 dhe bootstrap;
- të tregojë problemet në përmbajtje, prezantim dhe ato të faqeve responsive;
- të korrigjojë problemet në përmbajtje;
- të korrigjojë problemet në prezantim;
- të korrigjojë problemet e responsivitetit të faqeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik dhe në mjediset e punës në një studio. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete me mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin dhe kërkimin në internet etj. - Atyre duhet t’ju jepen detyra të zhvillojnë sektorët e faqes responsive. - Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Kompjutera, me programe aplikative të instaluar. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

6. Moduli “Aplikime në gjuhën Javascript”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	APLIKIME NË GJUHËN JAVASCRIPT	WD-06-2020
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me gjuhën Javascript, terminologjinë e gjuhës, funksionet dhe variablët e gjuhës, implementimin i tyre në shfletuesin (browser) mbi dokumentin HTML, sintaksën e gjuhës, deklaratat, funksionet, operatorët, kushtëzimet, objektet e javascript, DOM dhe eventet.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të ketë njohuri në programet bazë kompjuterike, të kenë kryer modulet “Hyrje në profesionin e Dizenjuesit të Web-it”, “Aplikime në gjuhën HTML”, “Aplikime në gjuhën CSS”, “Punime në programin photoshop” dhe “Ndërtimi i faqeve responsive”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e gjuhës Javascript dhe si aplikohet tek dokumenti, ndryshorët Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë javascript dhe strukturat e kontrollit; - të përshkruajë qëllimin dhe bashkëveprimin e	

-
- javascript me vizitorin e faqes;
 - të kryej aplikim të javascript mbi dokumentin HTML në menyra të ndryshme;
 - të përshkruajë ndryshorët në javascript;
 - të përcatojë llojet e ndryshorëve;
 - të përshkruajë përdorimin e ndryshorëve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti përdor operatorët aritmetikë në Javascript.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë elementët e një funksioni dhe sintaksën;
- të krijojë parametra për funksionin;
- të tregojë funksionet bazë;
- të përshkruajë operatore aritmetike;
- të përdorë operatorët aritmetikë;
- të realizojë veprime ndryshorësh me operatorët aritmetikë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti përdor operatorët krahasues dhe operatorët llogjikë.

Kriteret e vlerësimit:

kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë operatore krahasues dhe mënyrën e dhënies së vlerave;
- të përdorë operatorët krahasues;
- të zbatojë dhënien e vlerave të operatorëve;
- të tregojë llogjikën e ngjarjeve ;
- të përdorë operatorë llogjikë për zhvillimin e ngjarjeve;
- të përdorë operatorë në varësi të llogjikës Boolean.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM.4 Kursanti zhvillon funksionet e kushtëzuara, modelin DOM dhe eventet.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë funksionet e kushtëzuara;
- të zhvillojë sintaksën e funksioneve të kushtëzuara;
- të përdorë operatorë brenda funksioneve të kushtëzuar;
- të realizojë skenare të mundshëm me funksione të kushtëzuar;
- të përshkruajë ndërtimin e dom;

- të zhvillojë aksesimin e nyjeve të dokumentit dom;
- të përshkruajë eventet që ndodhin.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti zhvillon kontrollet e fushave të formave me Javascript.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë aksesimin e formave ;
- të aksesojë fushat bosh, me tekst apo me numër ;
- të aksesojë fushat e adresës elektronike, mesazheve;
- të aksesojë submit dhe onsubmit;
- të kontrollojë përmbajtjen e fushës për tekst, shifra;
- të kontrollojë përmbajtjen e fushës bosh;
- të kontrollojë përmbajtjen e fushës për kufizime, e-mail, password, mesazhe dhe ti kombinojë së bashku.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik dhe në mjediset e punës në një studio .
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete me mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin, kërkimin në internet etj.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës.
- Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Kompjuterat ,me programe aplikative të instaluar.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.